



VENDIM

Nr. 117, Datë 14.10.2015

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E MARRËVESHJES
SË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
NDËRMJET OSHEE SH.A DHE FURNIZUESIT E ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, pikës “V.1” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.06.2008; pikës 4.13 gërma “A” pikës 4 dhe pikës 7 gërma “g” paragraf. 1, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, date 19.03.2008 dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 14.10.2015, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s dhe draft- marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe “Furnizuesit” të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

Subjektet nënshkruese të kësaj marrëveshje do të jenë:

- Shoqëria “OSHEE” sh.a e licensuar nga ERE për kryerjen e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 96, datë 27.10.2014;
- Furnizuesi i Energjisë Elektrike (personi juridik i licensuar nga ERE për kryerjen e aktivitetit të furnizimit me energji elektrike), i cili do të lidhë me

- vullnetin e tij të lirë marrëveshjen me OSHEE sh.a, për sigurimin e furnizimit me energji elektrike të klientëve fundor.
- Po ashtu, konstatohet se dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr. 338 datë 19.03.2008, Rregullat e Tregut të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar.
 - Modeli i Tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori marrëveshjeje.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e draft – marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE sh.a dhe “Furnizuesit” e Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI